

Lija

(Lija e dhenve, Lija e ujit,
Spitze Blattern, Wilde Blattern)

«Lija e dhenve» është sëmundje ngjitëse e fëmijëve, e cila shkaktohet me kontaktin e parë me Varacela-Zoster-Viruset. Këto viruse barten me kontakt direkt me persona, të cilat në moment janë të sëmurë.

Simptomat

10-21 ditë pas infektimit fëmijët e fitojnë një dalje tipike të puçrrave dhe eventalisht edhe ethe. Këto puçrra hapen brenda pak orëve në tërë trupin. Nga kjo mund të preken edhe mukozat (goja, gjenitalet), më rrallë edhe sytë. Së pari paraqiten njolla të kuqe, të cilat më vonë shndërrohen në rruzuj. Në qendër të rruzujve krijohen shpejt fshikëzat, të cilat pëlcasin dhe së fundi thahen. Të gjitha këto forma mund të paraqiten njëkohësisht.

Terapia

Mjekimi i lisë kufizohet në zbutjen e kruarjes si dhe gjithsesi në uljen e temperaturës së trupit. Këtu mund të përdoren medikamentet vijuese:

- Pika për pirje kundër kruarjes (Anti-histaminikë p.sh. Dimetinden- maleat)
- Substanca për zbutjen e kruarjes me lyerje të skuqjes së lëkurës (Antipruriginosa)
- Ulja e etheve me qirinj apo sirup (Antipiretikë p.sh. Paracetamol)



Stacioni i emergjencës Spitali i fëmijëve Zürich

Telefoni për këshilla: +41 58 387 78 80

Komplikimet

Te fëmijët sëmundja kryesisht rrjedhë favorshëm. Rrallë mund të paraqiten komplikimet vijuese:

- Infektime bakteriale të lëkurës (kore e verdhë/qelbët me skuqje të hapur rreth kores)
- Pezmatim i veshit të mesëm, inflamacion të mushkërive.
- Inflamacion truri (Çrregullime të lëvizjeve ose çrregullime koordinimi në fund të sëmundjes apo më vonë)

Për persona me imunitet të dobët, lija mund të jetë e rrezikshme dhe të ketë rrjedhë të rëndë.

Parandalimi

Lija në moshën madhore është e rrallë, rrjedhë shpesh vështirë dhe dukshëm me ma shumë komplikime. Për këtë arsye të rinjtë (dhe të rriturit), të cilët deri me tani nuk kanë qenë të sëmurë nga lija, do të duheshin të vaksinohen. Disa fëmijë, p.sh të tillë me imunitet të

dobët, leukemi, apo neurodermitis, kanë rrezik më të lartë për rrjedhje të rëndë të lisë dhe me më shumë komplikime. Këta fëmijë dhe familjet e tyre duhet të këshillohen nga mjeku i tyre i fëmijëve apo shtëpisë, dhe për mbrojtje nga një sëmundje e tillë të vaksinohen me kohë.

Kur do të duhej të shkoni te mjeku juaj?

Te lija komplikimet tregohen nga shenjat vijuese:

- Dhimbjet (p.sh. dhimbje veshi, dhimbje koke) të cilat nuk humbin edhe me Paracetamol.
- Vështirësi gjatë frymëmarrjes
- Shenja për një infektim bakterial (kore e verdhë/qelbët me skuqje të hapur lëkure rreth kores)
- Vjellje dhe/ose marrje e pamjaftueshme/mangët e lëngjeve.
- Ecje papritmas e pasigurt, rrëzime të përsëritshme, dridhje
- Apo kur ju për një arsye tjetër bren-goseni për fëmijën tuaj